




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2005



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2005



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Dhjetor 2008

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: www.ks-gov.net/esk

P a r a t h ë n i e

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) për here te pare ka organizuar Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) në vitin 2006 për vitin referues 2005. ASN është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ESK dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve.

Kjo anketë me të dhënat që ofron, synon te paraqet strukturën e aktiviteteve ekonomike nëpërmjet treguesve ekonomik.

Rezultatet e të dhënave nga Anketa strukturore e ndërmarrjeve janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit.

Ky publikim është i pari i kësaj natyre dhe tani e tutje do të jetë publikim i rregullt i ESK-së. Pra do të jetë pjesë e punës në planin vjetor të ESK-së, me mundësi zgjerimi me parametra tjerë të nevojshëm për shfrytëzuesit dhe vendimmarrësit.

Falënderimi

ESK falënderon SIDA-n Suedeze për mbështetjen që i ka dhënë në realizimin e kësaj ankete. Falënderojmë ne veçanti ekspertin: Alma *Rutkauskiene* për përkrahje në përgatitjen e pyetësorit, përzgjedhjen e mostrës dhe metodologjinë e përdorur në anketën strukturore të ndërmarrjeve.

Nomenklatura e përdorur është bere nen përkujdesjen ekspertes, e mbështetur nga SIDA Suedeze.

Ky publikim është përgatitur nga personeli i Departamentit te statistikave ekonomike dhe LLK: Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit, Hysni Elshani, Valdete Navakazi, Hamide Kunushevc, Luljeta Krasniqi, Nazmije Belegu, Ibrahim Rrustemi, Arlinda Mataj.

ESK falënderon te gjitha ndërmarrjet që bashkëpunuan në mënyre korrekte si dhe MTI-ne Agjencionin për regjistrimin e bizneseve në Kosove, MFE- Administratën Tatimore te Kosovës.

ESK gjithashtu falënderon në mënyrë te veçante zyrtaret e zyrave rajonale te ESK dhe anketuesit nga departamenti, te cilët grumbulluan te dhënat nga ndërmarrjet me një angazhim vetëmohues.

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Prishtinë, Dhjetor 2008

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,
z. Avni Kastrati

Shkurtesat

ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTI	Ministria e Tregtise dhe Industrise
NKVE	Nomenklatura e klasifikimit te aktiviteve ekonomike
ARBK	Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve te Kosovës
:	Shifrat mungojnë
n/a	Nuk aplikohet

P e r m b a j t j a

Faqe

1	Objektivat, metodologjia dhe shtrirja e anketës	4
1.1.	Objektivat dhe shtrirja e anketës	4
1.2.	Metodologjia	4
1.3.	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE)	5
1.4.	Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës	5
1.5.	Dizajnimi dhe permbajtja e pyetsorit	6
1.6.	Procedurat e mbledhjes se te dhenave.	7
1.7.	Ngritja e te dhenave te anketes strukturore te ndermarrjeve ne nivel te vendit	8
2	Disa tregues dhe perkufizime themelorë	8
3	Numri i bizneseve, te punesuarve dhe paga mesatare	9
3.1.	Numri i bizneseve sipas aktiviteve ekonomike	9
	Tabela 1. Numri i bizneseve aktive në bazë të ATK-së per vitin 2005	9
3.2.	Numri i te punesuarve sipas aktiviteve ekonomike	10
	Tabela 2. Numri i të punesuarve sipas aktiviteve ekonomike - ASN 2005	10
3.3.	Paga mesatare sipas aktiviteve ekonomike	12
	Tabela 3. Paga mesatare sipas aktiviteve ekonomike –ASN 2005	12
4	Qarkullimi, shpenzimet dhe investimet	14
4.1.	Qarkullimi	14
	Tabela 4. Qarkullimi në bazë të aktiviteve – ASN 2005	14
4.2.	Shpenzimet	16
	Tabela 5. Shpenzimet në bazë të aktiviteve – ASN 2005	16
4.3.	Investimet	16
	Tabela 6. Investimet në bazë të aktiviteve – ASN 2005	17
	Tabela 7. Ndërmarrjet sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik - (me pergjegjie te mira te ASN 2005)	18
	Tabela 8. Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë në kuadër të aktivitetit ekonomik në % - (me pergjegjie te mira te ASN 2005)	18
	Tabela 9. Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik në % (me pergjegjie te mira te ASN 2005)	19

1 Objektivat, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivat dhe shtrirja e anketës

Qëllimi kryesor i Anketës Strukturore të Ndërmarrjes është paraqitja e strukturës së aktiviteteve ekonomike në Kosovë nëpërmjet treguesve ekonomik.

Rezultatet e të dhënave nga ASN janë burim i rëndësishëm i përpilimit të Bruto Produktit Vendor të Kosovës me qasjen e prodhimit. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacion më të plotë statistikor në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetin ekonomik e financiar të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në të gjithë territorin e vendit.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë të dhënat për degët ekonomike si: miniera, industri, energji, ndërtimtari, tregti, hotele dhe restorante, transport, posta, shërbime biznesi dhe shërbime tjera. Në anketë nuk përfshihen këto degë: bujqësia, pylltaria, peshkimi, financat dhe administrata publike, pasi që këto dege janë pjese e hulumtimeve tjera. Anketa ka zgjatur dy muaj e gjysmë në teren (nga gjysma e korrikut të vitit 2006 e deri në fund të shtatorit 2006). Bashkëpunimi me ndërmarrjet për realizmin e kësaj ankete ishte i kënaqshëm, një numër i vogël i bizneseve ka refuzuar të përgjigjet, për shkak të mos-azhurnimit të adresave disa nga ndërmarrjet nuk kanë mund të gjenden. Vetëm një numër i vogël i tyre nuk kanë treguar gatishmëri të bashkëpunimit në dhënien e shënimeve.

1.2. Metodologjia.

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim, është sipas rregullave të EU-së- Eurostat-it.

1.3. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE)¹.

A	BUJQËSIA,GJUEITIA DHE HORTIKULTURA
B	PESHKIMI
C	INDUSTRIA NXJERRËSE ²
D	INDUSTRIA PËRPUNUESE
E	PRODHIMI,SHPERNDARJA E ENERGJISË
F	NDËRTIMI
G	TREGËTIA,RIPARIMI I AUTOMOBILAVE DHE ARTIKUJVE SHTEPIAK
H	HOTELET DHE RESTORANTET
I	TRANSPORTI DHE TELEKOMUNIKACIONI
J	AKTIVITETI FINANCIAR
K	PASURIT E PATUNDSHME, DHENIA ME QIRA DHE SHERBIME PER NDERMJETESIM
M	ARSIMI
N	SHENDETESIA DHE VEPRIMTARITE SOCIALE
O	SHERBIME KOLEKTIVE,SOCIALE DHE PERSONALE
P	SHERBIME SHTEPIAKE
Q	AKTIVITETE TE ORGANIZATAVE DHE ORGANIZMAVE NDERKOMBETARE
R	AKTIVITETE TJERA BIZNESORE

1.4.Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Për krijimin e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) –MFE kryesisht për përcaktimin e kornizës së mostrës për qarkullimin vjetor të ndërmarrjeve dhe numrin e të punësuarve.

Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) MTI – (adresa, pronari, telefoni) dhe aktivitetet ekonomike të koduara sipas Nomenklaturës së Klasifikimit të Aktiviteteve Ekonomike NKVE 1.1 (“NACE Rev 1.1” eng). Aktivitetet më vonë janë azhurnuar me të dhëna nga anketa.

¹ Nomenklatura e Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike (NKVE) është mjet statistikor për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas aktivitetit të tyre ekonomik, shërben për përpunimin e të dhënave statistikore dhe ka gjetur zbatim në të gjitha vrojtimet pranë ndërmarrjeve.

² Në këtë seksion janë aktivitetet të minierave, gjegjësisht gurthyesve dhe reparacioneve të zhavorrit. Për qëllime me praktike në do të përdorim termin shkurt “Minierat”

Te dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë qenë bazë për përcaktimin e kornizës së mostrës. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë vitit 2005 ose 2004 janë konsideruar si ndërmarrje aktive për vitin 2005. Bazuar në këtë kriter, 38993 ndërmarrje janë konsideruar aktive gjatë vitit 2005. Pas anketës u vërejt se te gjitha ndërmarrjet qe kane deklaruar ne vitin 2004 ndonjërin nga tatimet ndersa ne vitin 2005 asnjërin, gjate mbledhjes se te dhënave u vërejt se asnjë biznes nuk kishte aktivitet andaj bazuar ne këtë duhet konsideruar se gjate vitit 2005 ishin 36625 ndërmarrje aktive dhe duhej korrigjuar mostra nga 3845 ne 3211 biznese

Të dhënat nga agjencioni për regjistrimin e bizneseve të Kosovës kanë shërbyer për: adresën e ndërmarrjes, aktivitetin kryesor sipas NACE Rev.1.1 emrin e pronarit ose personit kontaktues, numrin e telefonit (për këtë qëllim janë shfrytëzuar edhe regjistra të ndryshëm telefonik).

Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të dy kritereve

- Kriteri i parë, ka qenë gjithë përfshirja e ndërmarrjeve me qarkullim vjetor mbi 50 000 euro në vit dhe
- Kriteri i dytë gjithë përfshirja e ndërmarrjeve që nuk e kanë plotësuar kriterin e parë, por kanë pas numër të të punësuarve 10 e më tepër, përfshirë edhe pronarët të cilët punojnë, punëtorët me pagesë dhe punëtor anëtar të familjes.

Korniza (popullimi)	36,625
Mostra	3,211
<i>Madhësia e mostrës ne %</i>	8.8
Përgjigjja te mira	2,441
<i>Norma e përgjigjeve %</i>	76.0
Biznese qe kane refuzuar apo nuk janë gjetur adresat	790

1.5. Dizajnimi dhe permbajtja e pyetsorit

Varësisht prej nevojave të të dhënave është bërë përgatitja e pyetësorit. Plotësimi i kërkesave për llogaritë Kombëtare respektivisht përpilimin e bruto produktit vendor në qasjen e prodhimit, ka qenë qëllimi kryesor.

Pyetësori i përdorur për grumbullimin e informacionit pranë ndërmarrjeve është konceptuar në 2 pjesë:

- Rubrika e përbashkët, me të dhëna të përgjithshme për të gjitha ndërmarrjet.
- Rubrika specifike, e cila përmban tregues specifik për çdo aktivitet ekonomik.

Fillimisht *pjesa e parë* ka qenë identifikimi i ndërmarrjes me të dhëna si: numri i regjistrimit të biznesit, emri i biznesit, përshkrimi i aktivitetit ose aktivitetëve nëse ka pasur dy a më tepër aktivitete, adresa e saktë, emri i pronarit, gjegjësisht pronarëve, personi kontaktues dhe koha kur është kryer anketa.

Kapitulli i dytë përmban: numrin e të punësuarve, numrin e pronarëve që punojnë, numrin e anëtarëve të familjes që punojnë pa pagesë dhe numrin e të punësuarve me pagesë. Të gjitha këto të ndara në kategori sipas gjinisë³.

Kapitulli i tretë përmban pyetjet për koston e personelit, pagat dhe mëditjet duke përfshirë edhe pjesën e pensioneve që biznesi i paguan për të punësuarit⁴.

Kapitulli i katërt ka të bëjë me qarkullimin e ndërmarrjeve dhe atë për mallrat e prodhuara nga ndërmarrja, mallrat nga tregtia dhe shërbimet dhe nën-kontraktuesit. Në fund të pyetësorit për ndërmarrjet që kanë pasur dy e më tepër aktivitete ekonomike është shtuar si aneks i kapitullit të katërt IV, si IVA për informim të analitik për qëllim të identifikimit të aktivitetit kryesor dhe aktiviteteve tjera.

Kapitulli i pestë përshinë blerjet që biznesi ka kryer për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Në këtë kapitull përfshihen shpenzimet e ndërmarrjes minus pagat dhe mëditjet, minus blerjet për qëllime të investimeve, minus tatimet e paguara dhe pagesat tjera që nuk janë në funksion të prodhimit si p.sh dënimet gjyqësore etj.

Kapitulli i gjashtë ka të bëjë me tatimet, taksat dhe licencat e paguara nga ndërmarrja për periudhën 2005.

Kapitulli i shtatë ka të bëjë me ndryshimin e gjendjes së stoqeve për: repromaterial, karburante pajisje të vogla, për mallrat e blera për rishitje, për gjysmë prodhime dhe për prodhime finale.

Kapitulli i tetë ka të bëjë me investimet kapitale dhe ato të kategorizuara si në : tokë, ndërtesa dhe ndërtime, makineri dhe pajisje, përfshirë edhe kompjuterët, vetura dhe mjete tjera të transportit dhe ndërtime apo prodhime për nevojat e tyre.

Kapitulli i nëntë dhe i fundit ka të bëjë me shitjen e mjeteve themelore. Për qëllime të identifikimit të investimeve negative dhe nxjerrjes së investimeve në shkallë vendi është aplikuar ky modul.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejme të anketës në tërësi, faqja e fundit e pyetësorit është parapare për vërejtje dhe komente të të intervistuarve që kryesisht kanë qenë kontabilistët e ndërmarrjeve.

1.6.Procedurat e mbledhjes së të dhënave.

Ne mbledhjen e të dhënave ne kemi aplikuar metodat të cilat i kemi konsideruar me efikasë për kushtet tona.

Anketimi është kryer me metodën e interëvistimit të drejtpërdrejt (face to face) nga anketuesit e ESK-së. Shpërndarja e materialit në ndërmarrje si dhe mbulimi i terrenit është bërë përmes zyrave tona në shtatë qendrat e mëdha të Kosovës⁵.

Anketuesit i kanë dorëzuar pyetësorët tek ndërmarrjet si njësi raportuese dhe iu kanë sqaruar kryesisht kontabilistëve të ndërmarrjeve për plotësimin e tyre. Në shumicën e rasteve anketuesit iu kanë lënë pyetësorët këtyre ndërmarrjeve me qëllim të plotësimit të tyre dhe pas disa ditëve po të njëjtit i kanë marrë të plotësuar. Vetëm tek një numër i vogël i ndërmarrjeve mundësitë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike janë zbatuar.

³ Kjo ndarje është kryer me kërkesë të statistikave gjinore.

⁴ Në bazë të ligjit mbi pensionet në Kosovë ndërmarrja është e obliguar që të paguaj për pension (min) 5% të pages bruto dhe në baza vullnetare deri në 15% të pages bruto

⁵ Në strukturën organizative të ESK janë shtatë zyra rajonale të anketuesve që mbulojnë tërë territorin e Kosovës. Këto zyra janë të vendosura në qendrat e mëdha të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Pejë dhe Gjakovë.

1.7.Ngritja e te dhenave te anketes strukturore te ndermarrjeve ne nivel te vendit

Me qellim te perfitimit te rezultateve nga anketa strukturore e ndermarrjeve ne nivel te vendit, te dhenat bazike nga anketa jane ngritur duke perdorur koeficientet. Keta koeficiente jane kalkuluar si raport i qarkullimit te ndermarrjeve nga ASN per aktivitet e caktuara dhe qarkullimit te pergjithshem te te njegtave aktivite nga te dhenat e ATK-se. Per verifikim te rezultateve te fituara sipas degëve jane perdorur edhe tregues tjerë si p.sh. numri i te punësuarve te deklaruar ne ATK, llojet e caktuara te tatimeve te paguara etj.

2 Disa tregues dhe perkufizime themelore

Në vitin 2005, Mbi 36 mijë ndermarrje kanë qenë aktive, me gjithsej 72 mijë të punësuar. 26,7 % e tyre punuan në tregti.

Ndërmarrjet tregtare për nga numri i tyre (mbi 20 mije) dominojnë në ekonominë Kosovare me 55.4 % të numrit te pergjithshëm.

Gjatë vitit 2005, numri i ndermarrjeve në aktivitetet ekonomike të minierave, gjegjësisht gurthyesve dhe separacioneve te zhavorrit, industrisë, energjisë dhe ndërtimtarisë arrijnë mbi 6 mije dhe punësojnë rreth 38 % të totalit të të punësuarve.

Investimet janë realizuar afërsisht 203 milion Euro ne vitin 2005. Mbi 75% e investimeve janë ne tri dege: Transport posta dhe telekomunikacion këto përfaqësojnë, në tregti, në energji.

Prodhimi i aktiveve të qëndrueshme nga ndermarrja për llogari të vet përfshinë: prodhimin e të gjitha produkteve që prodhuesit e tyre i ruajnë për formimin e bruto kapitalit fiks për llogari të vet. Shënojmë se ky prodhim është gjithashtu pjesë e investimeve.

Investimet përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndermarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë edhe tokën.

Vlera e qarkullimit përfshinë shumat e faturuara nga ndermarrja gjatë periudhës së marrë në shqyrtim dhe i korrespondon shitjes në treg te të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Madhësia e ndermarrjes – kriter për përcaktimin e madhësisë së ndermarrjes ka qenë numri i të punësuarve. Kështu prej 1 deri 9 – janë ndermarrje të vogla , prej 10 - 49 të mesme dhe mbi 50 e më tepër të punësuar janë biznese të mëdha.

3 Numri i bizneseve, te punesuarve dhe paga mesatare

3.1. Numri i bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike


Gjate vitit 2005 ne baze te kriterit te deklarimit njerin nga tatimet 36 625 ndermarrje kane qene aktive. Ne kete numer nuk bejne pjese këto degë: bujqësia, pylltaria, peshkimi, financat dhe administrata publike. Ky numer eshte konsideruar korniza per moster per ASN 2005.

Tabela 1. Numri i bizneseve aktive në bazë të ATK-së per vitin 2005

Seksionet	Përshkrimi i aktivitetit ekonomik	Numri i bizneseve	%
C	Minierat	144	0.4
D	Industria	3,914	10.7
E	Energjia	13	0.0
F	Ndertimtaria	1,894	5.2
G	Tregtia	20,281	55.4
H	Hotelet&Restorantet	3,226	8.8
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	3,676	10.0
K	Sherbime biznesore	1,297	3.5
O	Sherbime tjera	2,180	6.0
Gjithsej		36,625	100.0

Pjesa me e madhe e ndermarrjeve i takojne tregtise (me mbi 55 %). Pjesa tjeter kryesisht janë nga degët: Industri (10.7%), transport, post dhe telekomunikacion (10.0%), Hotele&Restorante (8.8%), Ndertimtari (5.2%), sherbime bisnesore (3.5%), sherbime tjera (6.0%) etj. Nje strukture ndryshe nga kjo eshte ajo per numrin e te te punesuarve sipas degeve ekonomike

Graf 1. Struktura e ndermarrjeve per vitin 2005 sipas aktiviteve ekonomike




3.2. Numri i te punesuarve sipas aktiviteve ekonomike

Numri i pergjithshem i te punesuarve gjate vitit 2005 ka qene 72 185. Ne kete numer nuk bejne pjese te punesuarit ne degët ekonomike: bujqësi, pylltari, peshkim, financa dhe administrate publike.

Tabela 2. Numri i të punesuarve sipas aktiviteve ekonomike - ASN 2005

Seksionet	Aktiviteti	Numri i të punesuarve	%
C	Minierat	3,798	5.3
D	Industria	8,149	11.3
E	Energjia	9,858	13.7
F	Ndertimaria	5,792	8.0
G	Tregtia	19,253	26.7
H	Hotelet&Restorantet	9,420	13.0
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	7,857	10.9
K	Sherbime biznesore	4,857	6.7
O	Sherbime.tjera	3,201	4.4
Gjithsej		72,185	100.0

Sa i perketë strukturës së të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike pjesa më e madhe janë në tregti me 26.7%. Tregtia në Kosovë karakterizohet me numër të madh të ndermarrjeve të vogla me pak të punësuar, kryesisht janë biznese familjare me një të vetëpunësuar. Të punësuarit tjerë janë kryesisht në deget: energjetik (13.7%), Hotele&Restorante (13.0%), Industri (11.3%), Transport, poste dhe telekomunikacion me (10.9%), Ndertimtarë (8.0%), Miniera (5.3%) dhe shërbime tjerë (4.4%).



3.3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike


Paga mesatare eshte nje tregues me rendesi. Ajo eshte kalkuluar duke pjestuar pagat dhe meditet bruto⁶ per tere vitin, per numrin e te te punesaur dhe 12 muajt e vitit.

Tabela 3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike –ASN 2005

Seksione	Aktiviteti	Nr.i punësuarve	Pagat dhe meditje (ne mije euro)	Paga mesatare mujore €
C	Minierat	3,798	8,551	188
D	Industria	8,149	19,548	200
E	Energjia	9,858	44,093	373
F	Ndertimtaria	5,792	14,435	208
G	Tregtia	19,253	64,393	279
H	Hotelet&Restuarantet	9,420	17,635	156
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	7,857	52,461	556
K	Sherbime biznesore	4,857	11,657	200
O	Sherbime tjera	3,201	8,117	211
	Gjithsej	72,185	243,530	281

Treguesi i pages mesatare prej 281 Eurosh per vitin 2005 ne aktivitetet e perfshira ne ankete eshte nje tregues i perafert me realitetin tone. Siç edhe mund te verehet paga mesatare me e lartë eshte ne sektorin e Postë dhe telekomunikacionit, derisa ajo më e ulta është në sektorin e hotelierisë dhe restoranteve.

⁶ Ne pagen bruto jane kunsideruar edhe pjesen e pension qe pronari paguan per punetorin.



4 Qarkullimi, shpenzimet dhe investimet.


4.1. Qarkullimi.

Vlera e qarkullimit përfshinë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së marrë në shqyrtim dhe i korrespondon shitjes në treg të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Tabela 4. Qarkullimi në bazë të aktiviteteve – ASN 2005

<i>Seksionet</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Numri i Bizneseve</i>	<i>Qarkullimi (ne mije)</i>	<i>%</i>
C	Minierat	144	104,274	3.8
D	Industria	3,914	183,089	6.8
E	Energjia	13	287,585	10.6
F	Ndertimtaria	1,894	152,665	5.6
G	Tregtia	20,281	1,530,293	56.5
H	Hotelet dhe Restoranet	3,226	39,373	1.5
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	3,676	252,245	9.3
K	Shërbime biznesore	1,297	127,099	4.7
O	Shërbime tjera	2,180	31,904	1.2
Gjithsej		36,625	2,708,527	100.0

Qarkullimi i realizuar nga ndërmarrjet ekonomike gjatë vitit vlerësohet të jetë rreth 2.71 miliard Euro. Rreth 57 % e këtij qarkullimi është realizuar nga aktiviteti i tregtisë, i cili aktivitet i takon ndërmarrjeve të mesme, kurse të tjerat veprimtari rezultojnë me një përqindje me të vogël të qarkullimit. Kështu në grupin e ndërmarrjeve që kanë përqindje me të vogël janë hotelet dhe restorantet me 1.5% dhe shërbimet tjera me 1.2%



4.2. Shpenzimet

Tabela 5. Shpenzimet në bazë të aktiviteteve – ASN 2005

<i>Seksionet</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Numri i Bizneseve</i>	<i>Shpenzimet (ne mije €)</i>	<i>%</i>
C	Minierat	144	93,658	4.1
D	Industria	3,914	154,393	6.7
E	Energjia	13	236,612	10.3
F	Ndertimtaria	1,894	123,156	5.4
G	Tregtia	20,281	1,473,753	64.3
H	Hotelet dhe Restoranet	3,226	27,811	1.2
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	3,676	112,137	4.9
K	Sherbim.biznesi	1,297	51,833	2.3
O	Sherbime.tjera	2,180	16,906	0.7
Gjithsej		36,625	2,290,260	100.0

Duke u bazuar në anketën strukturore të biznesit shpenzimet gjatë vitit 2005 janë 2,290,259,551 ne vlerën totale të të gjitha aktiviteteve. Bazuar nga të dhënat me lartë shohim se shpenzimet më të vogla janë në restorantet 1,2% dhe në shërbimet tjera 0,7% kurse shpenzimet më të theksuara janë në aktivitetin e tregtisë me rreth 64% çka edhe është reale dhe në proporcion me numrin e bizneseve .

4.3. Investimet.

Investimet për qëllimet e anketës mbulojnë Blerjet e: tokës, ndërtesave dhe ndërtimeve për veten e tyre, makinerive dhe pajisjeve, mjeteve transportuese (me qëllim të shfrytëzimit afatgjatë).

Anketa strukturore e ndërmarrjeve 2005 për degët përkatëse, tregon se Investimet e realizuara gjatë vitit 2005 ishin mbi 202.7 milion euro.

Tabela 6. Investimet në bazë të aktiviteteve – ASN 2005

<i>Seksionet</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Numri i Bizneseve</i>	<i>Investimet (ne mije €)</i>	<i>%</i>
C	Minierat	144	13,341.5	6.6
D	Industria	3,914	17,433.0	8.6
E	Energjia	13	45,146.2	22.3
F	Ndertimtaria	1,894	13,029.3	6.4
G	Tregtia	20,281	56,683.5	28.0
H	Hotelet dhe Restoranet	3,226	3,668.9	1.8
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	3,676	52,688.6	26.0
K	Sherbim.biznesi	1,297	197.7	0.1
O	Sherbime.tjera	2,180	552.5	0.3
Gjithsej		36,625	202,741.1	100.0

Struktura e investimeve sipas sektorëve të veprimtarive është e ndryshëm. Mbi 75% e investimeve janë në tri degë: në Transporti, postat dhe telekomunikacion këto përfaqësojnë rreth 26%, në tregti 28%, në energji rreth 22.3%. Nivel më i vogël i investimeve gjatë vitit 2005 ka ndodhur në Industri 8.6%, Miniera 6.6%, Ndërtimtaria 6.4%. Nivel i ulët i investimeve konstatohet në degët Hoteleri dhe restorante 1.8% shërbimeve tjera me 0.3% dhe shërbime biznesi 0.1%.




Tabela 7. Ndërmarrjet sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik - (me përgjegje të mira te ASN 2005)

<i>Kategorizimi sipas numrit të të punësuarve</i>					
<i>Seksionet</i>	<i>Aktivitet</i>	<i>Të vogla (0- Të mesme (10- Të mëdha (50</i>			<i>Gjithsej</i>
		<i>9)</i>	<i>49)</i>	<i>e mbi)</i>	
C	Minierat	5	15	3	23
D	Industria	61	266	34	361
E	Energjia	-	1	8	9
F	Ndertimtaria	36	177	15	228
G	Tregtia	629	714	24	1,367
H	Hotelet dhe restorantet	17	129	1	147
I	Transporti, postat dhe telekom	30	76	10	116
K	Sherbime biznesi	17	39	7	63
O	Sherbime tjera	16	56	17	89
Gjithsej		811	1,473	119	2,403

Në këtë tabelë kemi prezentuar numrin e bizneseve responduese (që janë përgjigjur në anketë) në bazë të madhësisë , ku lehte mund të vërejmë se numri më i madhë i tyre bënë pjesë në kategorinë e bizneseve të mesme.

Tabela 8. Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë në kuadër të aktivitetit ekonomik në % - (me përgjegje të mira te ASN 2005)

<i>Kategorizimi sipas numrit të të punësuarve</i>					
<i>Seksionet</i>	<i>Aktivitet</i>	<i>Të vogla</i>	<i>Të mesme</i>	<i>Të mëdha</i>	<i>Gjithsej</i>
		<i>(0-9)</i>	<i>(10-49)</i>	<i>(50 e mbi)</i>	
C	Miniera	21.7	65.2	13.0	100.0
D	Industri	16.9	73.7	9.4	100.0
E	Energji	-	11.1	88.9	100.0
F	Ndertimtari	15.8	77.6	6.6	100.0
G	Tregti	46.0	52.2	1.8	100.0
H	Hotelet dhe restorantet	11.6	87.8	0.7	100.0
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	25.9	65.5	8.6	100.0
JKL	Sherbim .biz	27.0	61.9	11.1	100.0
O	Sherbime tjera	18.0	62.9	19.1	100.0
Gjithsej		33.7	61.3	5.0	100.0

Gjatë vitit 2005 kanë ushtruar veprimtarinë e tyre 40275 ndërmarrje. Në baze të anketës strukturore të biznesit veçojmë faktin se 61% të ndërmarrjeve janë te mesme pothuajse ne te gjitha aktivitetet, me përjashtim te energjisë ku numri me i madh i takojnë ndërmarrjeve te mëdha me 89%.e po ashtu vlen të theksohet se në këtë lloj veprimtarie nuk kemi asnjë ndërmarrje te vogël .

Tabela 9. Struktura e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe aktivitetit ekonomik në % (me pergjegjie te mira te ASN 2005)

Seksionet	Aktivitetet	Kategorizimi sipas numrit te te punësuarve			Gjithsej
		Të vogla (0-9)	Të mesme (10-49)	Të mëdha (50 e mbi)	
C	Miniera	0.6	1.0	2.5	1.0
D	Industri	7.5	18.1	28.6	15.0
E	Energji	-	0.1	6.7	0.4
F	Ndertimtari	4.4	12.0	12.6	9.5
G	Tregti	77.6	48.5	20.2	56.9
H	Hotelet dhe restorantet	2.1	8.8	0.8	6.1
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	3.7	5.2	8.4	4.8
K	Sherbimet biznesore	2.1	2.6	5.9	2.6
O	Sherbime tjera	2.0	3.8	14.3	3.7
Gjithsej %		100.0	100.0	100.0	100.0

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:** Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** ekonomic@ks-gov.net
- **Ueb-faqe:** www.ks-gov.net/esk